

Pranuar - Print/eno Më/Dana 19-04-2022 vit/god			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtetëse Prilog	Vlera Wednost
02-035/02-405			

**Republika e Kosovës/ Republika Kosovo/ Republic of Kosovo  
Komuna e Vitisë/ Opština Vitina/ Municipality of Viti/na**

Në bazë të nenit 13,58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale me Nr.03/L-040.Neni 24 te Rregullores (QRK) Nr.01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme , nenit 51.1 i Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491 të dates:21.04.2011. Kryetari i Komunës së Vitisë nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**Për themelimin e Komisionit Komunal për Kthim**

**Neni I**

Me këtë vendim themelohet Komisioni Komunal për kthim  
Komisioni ka këtë përbërje:

- 1.Kryesuesin e Komisionit Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim Zoran Marinkoviç
- 2.Përfaqësuesi nga Drejtoria e Arsimit Shqipe Rexhepi
3. Përfaqësuesi nga Drejtoria e Shëndetësisë Arian Alidema
4. Përfaqësuesi nga Drejtoria e Pinës dhe mirëqenies sociale Shaqir Zuka
5. Përfaqësuesi nga Drejtoria eshërbimeve e publike Naser Haziri
6. Përfaqësuesi nga Drejtoria e Planifikim dhe urbanizëm Zymrije Salihu
7. Përfaqësuesi nga Drejtoria e Hidajete Aliu
8. Përfaqësuesi nga MKK-së Zeqirijah Morina

**Neni II**

Tek projektet bilaterale çështja e pjesëmarrjes dhe roli i përfaqesuesit në Komisionin Komunal për Kthim nga radhët e donatorit rregullohet me marrëveshje në mes MKK-së. Komunës dhe donatorit.

**Neni III**

UNHCR-ja ka rolin këshillues në Komisionin Komunal për Kthim.

**Neni IV**

Komisioni komunal për kthim duhet të reflektoj përbërje etnike dhe gjinore.si dhe do të jetë i hapur për organizatat e shoqërisë civile dhe organizatat ndërkombëtare për qëllim të monitorimit.

**Neni V**

Komisioni Komunal për Kthim është organ rekomandues. i cili propozon rastet për vendim tek Komisioni Qendror Shqyrtues në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim.Mandati i anëtarëve të komisionit është tri vite me mundësi të vazhdimit për edhe një mandat.

**Neni VI**

Ky vendim. hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

- 1.Anëtarëve të këtij Komisioni
- 2.Zyres së Kryetarit
- 3.Arkivit

